

Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtorija për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 410104-28695
Data/Datum 19.12.2022
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

DATE/A:	19.12.2022
PËR/ZA/TO:	Valentina Tahiraj Drejtor i Kompanisë “NIVA Construction” SH.P.K. dhe përfaqësues i konzorciumit “NIVA Construction” SH.P.K. & “ Beni Construction” SH.P.K., Prishtinë
Kopje/Copy/	Arkiva e Komunës Durim Halilaj, Drejtor për Buxhete dhe Financa - Komuna Gjakovës Rexhë Rexha, Menaxher i kontratës së AK
PËRMES /PREKO/THROUGH	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Faton Gutaj, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për shkëputjen e kontratës –“ Sanimi i rrugëve “Ismajl Qemajli” dhe “Sylejman Hadum Aga” me pllaka graniti” me numër identifikues: 632-21-1829-5-2-5 dhe nr.brendeshem 632-21-030-525

I/E nderuar/a,

Ju informojmë se kontrata për “ **Sanimi i rrugëve “Ismajl Qemajli” dhe “Sylejman Hadum Aga**, e nënshkruar me datën 29.04.2021, **me numër identifikues: 632-21-1829-5-2-5 dhe numër të brendshëm 632-21-030-525**, ne mes te Komunës së Gjakovës dhe kontraktuesit “NIVA Construction” SH.P.K. & “ Beni Construction” SH.P.K., **prej datës 20.12.2022, ndërpritet**, duke u bazuar në shkresën e MKRS-së- Sektori i Trashëgimisë Kulturore, nr.2105/2022, të dt.19.05.2022 dhe kërkesës nga menaxheri i kontratës, të dt.19.12.2022, për shkëputje të kontratës .

Në shkresën e dt.19.05.2022, të MKRS-së- Sektori i Trashëgimisë Kulturore, është kërkuar nga Autoriteti kontraktues që të mos vazhdoj me ndërtimin e kësaj rruge sipas projektit me pllaka graniti por të hiqen pllakat dhe të punohet projekti i ri ku punimet të kryhen me kubëza graniti.

Meqë ju si kontraktues nuk jeni pajtuar që të bëjmë shkëputje të kontratës me marrëveshje, jemi të detyruar që të bëjmë shkëputje të njëanshme të kontratës, duke u bazuar në shkresën e MKRS-së- Sektori i Trashëgimisë Kulturore nr.2105/2022, të dt.19.05.2022.

Shkresës i bashkëngjiten komunikimet me MKRS-në.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



<i>Data:</i>	19.12.2022
<i>Për:</i>	Zyrën e prokurimit – z. Faton Gutaj
<i>Përmes:</i>	
<i>Nga:</i>	Menaxheri i Projektit – Rexhë Rexha;
<i>Kopje:</i>	DSHP– z. Shkumbin Kastrati AL- Engineering, Prishtinë; Valdrin Zenuni – Organi Mbikëqyrës OE "Niva Construcion" sh.p.k. Prishtinë z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës, Gjakovë
<i>Lënda:</i>	Kërkesë për shkëputje te kontratës me titull: Sanimi i rrugëve "Ismail Qemjali" dhe Sylejman Hadum Aga" me pllaka graniti me nr. prok. 632-21-1829-5-2-5

Ju njoftojmë se: Punimet kanë filluar sipas urdhëresës të lëshuar nga Projekt Menaxheri me datën 10.09.2021. Pas kryerjes se disa punimeve bazuar në raportin e organit Mbikëqyrës dhe vizitës në terren, **situacioni i I-rë** i projektit; **Sanimi i rrugëve "Ismail Qemjali" dhe "Sylejman Hadum Aga" me pllaka graniti** me nr. prok. 632-21-1829-5-2-5 është kryer sipas pozicioneve të paraqitura te punimeve në vlerë prej 55,049.18€ dt. 09.11.2021 dhe raporti i Organit mbikëqyrës me 11.11.2021.

Janë ndërprerë punimet edhe pse projekti ka qenë i pranuar nga MKRS-ja të gjegjësisht;

– **SEKTORI I TRASHEGEMISE KULTURORE** cilët kanë kërkuar që kanë ndërhy ne projekt dhe kanë thënë që të behet me kubza graniti "PUNIMI I FORMES SE QILIMIT"

Pastaj ka pasur pakënaqësi prapë nga MKRS-ja të gjegjësisht – **SEKTORI I TRASHEGEMISE KULTURORE**, disa herë kemi tentuar qe te bisedojmë mirëpo ka qenë e kotë. Me datën 19.05.2022 MKRS-ja të gjegjësisht – **SEKTORI I TRASHEGEMISE KULTURORE** janë drejtuar me një shkresë për mos lejim e ndërtimit të kësaj rruge sipas projektit me pllaka graniti por të hiqen pllakat dhe te punohet një projekt i ri ku punimet te kryhen në vend të pllakave të granitit të ndërtohet me kubëza graniti.

Duke u bazuar në gjendjen faktike pas mos lejimit te kryerjes së punimeve(nuk kemi mundësi te realizimit te segmentit rrugor për shkak te pengesave te paraqitura më lartë) në bazë të kontratës me titull: Sanimi i rrugëve " Ismajli Qemjali " dhe Sylejman Hadum Aga" me pllaka graniti me nr. protok. 632-21-1829-5-2-5 dhe deri sa te zgjidhet me MKRS-në një formë tjetër e punimeve.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Ref. Nr. 21051/2022
Data 19.05.2022
Drejtoria
Nënshkrimi
Llogaritja
PRISHTINË/PRISHTINA, PRISHTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta -
Ministry of Culture, Youth & Sports

Departamenti i Trashëgimise Kulturore

REFERENCË:		30/2022			
PËR/ZA/TO:		Komuna e Gjakovës Drejtorja per Shërbime Publike z. Shkumbin Kastrati, drejtor			
CC:		z. Bislim Bislimi Zëvendësues Sekretar i Përgjithshëm			
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Vjollca Aliu, Udhëheqëse e Departamentit			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Dokumentacioni- kriteret dhe udhëzimet per hartim te projektit			
Nr. i zyrës:	239	Lokacioni:	22557	Data:	19.05.2022
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Faqe 1 nga 2

I nderuar drejtor,

Ne reference te komunikimit per sa i përket projektit per Çarshinë e madhe ne Gjakove respektivisht shtrimit te dyshemesë ne bërthamën e çarshisë, vendimeve paraprake dhe pas takimit te mbajtur ne Cjakoce, bashkangjitur kësaj shkrese ju dërgojmë:

Dokumentin mbi bazën e te cilit duhet te hartohet projekti dhe shtojcën e cila duhet te plotësohet. Dokumentacioni i plotësuar dhe projekti me tutje duhet te dorëzohet ne Komisionin Profesional te Institutit te Kosove per Mbrojtje te Monumenteve.

Bashkangjitur kësaj shkrese:

- 1.Dokumentacioni- kriteret dhe udhëzimet per hartim te projektit
- 2.Shtojcat
- 3.Kopja e Vendimit te Komisionit te Ankesave.

Duke ju falënderuar per bashkëpunim, mbesim ne dispozicionin e juaj per ndonjë paqartësi apo/dhe informatë plotësuese.

Me respekt.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministarstvo za Kulturu, Omladinu i sport,
Ministry of Culture, Youth of Sports**

Ansambli i Çarshisë së Madhe të Gjakovës është e listuar në Listën e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, Vendimi nr. 129/2021 dt. 10.10.2021, me numër unik 334, me emërtimin "Tërësisë Urbanistike Çarshia e Madhe."

Tërësia urbanistike e Çarshisë së Madhe përmban 525 objekte të rëndësishme. Njihet si çarshia më e madhe në Evropën Juglindore. Ka kryer funksionin e zejtarisë, tregtisë dhe administratës qendrore të asaj kohe. Sot është kompleks kulturo-historik, turistik, zejtar dhe tregtar. Të gjitha ngjarjet që lidhen me qytetin e Gjakovës lidhen e kanë me zhvillimin e Çarshisë së Madhe. Karakteristikë arkitektonike është ndërtimi i saj, stili i ndërtimit është tradicional, me material vendas.

Hartimi i Planit të Konservimit të "Tërësisë Urbanistike Çarshia e Madhe" klasifikuar si trashëgimi kulturore arkitekturale – ansambël, do të kërkojë një qasje multi-disiplinare.

Të gjitha ndërhyrjet që planifikohen duhet të jenë rezultat i një plani të integruar – Projekti i Konservimit, i cili do t'i ngërthejë në vete aspektet e ndryshme të funksionit brenda projekteve të arkitekturës, planifikimit urban dhe planit infrastrukturor.

Projekti i Konservimit duhet të jetë në harmoni të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me konventat e kartat ndërkombëtare të UNESCO-s dhe ICOMOSIT në lidhje me konservimin e trashëgimisë kulturore.

Prandaj, bazuar në vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS nr. 142/2022 të datës 23.02.2022, dhe vendimin në fuqi nr.02/2021 i datës 04.10.2021 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave (tutje: Komisioni i Ankesave) kundër vendimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, grupi punues specifikon parimet e konservimit për hartimin e detyrës projektuese për Tërësinë Urbanistike Çarshia e Madhe si në vijim:

1. PARIMET E KONSERVIMIT

Parimet që do të udhëheqin procesin e përpilimit të projektit për intervenim në "Tërësinë Urbanistike Çarshia e Madhe" janë:

- Mjedisi historik është një pasuri e përbashkët;
- Të gjithë duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në ruajtjen e mjedisit historik.

Duke u nisur nga fakti që materiali autentik është burimi kryesor i diturisë dhe kuptimit të historisë së Tërësisë Urbanistike, dhe materialet dhe metodat e ndërtimit të mishëruara në materialin e saj ilustrojnë ndryshimet në idetë, shijet, aftësitë e njerëzve për ndërtim dhe marrëdhëniet e tyre me rrethinë – atëherë, qasja për konservimin e Tërësisë Urbanistike të Çarshisë së Madhe duhet të kombinojë parime të dëshmuara mirë me teknikat praktike të konservimit të bazuara në Kartat dhe Konventat ndërkombëtare për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Rrjedhimisht:

- Filozofia e konservimit për ndërtesat në Çarshinë e Gjakovës bazohet në ruajtjen maksimale të materialit origjinal dhe autentik, kthimin e gjendjes burimore në rastet që mbështeten në të dhëna faktike si dhe adaptimin e ndërtesave për nevoja të kohës.
- Punët do të ekzekutohen me respekt ndaj metodave teknologjike tradicionale duke iu përmbytur autenticitetit material dhe shpirtëror;
- Vendimet për ndryshimin duhet të jenë të arsyeshme, transparente dhe konsistente;
- Ruajtja më e mirë është menaxhimi dhe mirëmbajtja e rregullt.

2. AKTIVITETET KONSERVUESE DHE PARIMET MBI TË CILAT ATO MUND TË ZHVILLOHEN

Rinovimi periodik i elementeve të Tërësisë Urbanistike është i dëshirueshëm, përveç nëse shkakton dëm të pa-rikuperueshëm në vlerat e trashëgimisë.

Intervenimet e reja dhe riparimet e domosdoshme për të mbajtur vlerat e trashëgimisë janë të dëshirueshme nëse:

1. Ka informacion të mjaftueshëm në mënyrë gjithëpërfshirëse për të kuptuar ndikimin e propozimit në vlerat e përgjithshme të Tërësisë Urbanistike;
2. Pasojat afatgjata të propozimeve, nga përvoja, mund të dëshmohen të jenë të mira, ose propozimet janë krijuar për të mos paragjykuar zgjidhje alternative në të ardhmen; dhe
3. Propozimi posedon cilësi të projektimit dhe ekzekutimit e cila mund të vlerësohet tani dhe në të ardhmen.

Restaurimi lejohet të bëhet vetëm me materiale kompatible me ato origjinale dhe me teknikat tradicionale të ndërtimit, ne rast se:

1. Elementet që parashihet të rivendosen nuk i konkurrojnë vlerat e materialit original ose autentik;
2. Intervenimi i propozuar bazohet në të dhëna faktike mbi gjendjen autentike dhe implementohet sipas tyre;
3. Intervenimet e propozuara respektojnë format e mëparshme të asetit.

Rekonstruimet lejohen vetëm në raste të rralla për asetet të cilat janë në masë të madhe të dëmtuara, dhe për to posedojmë të dhëna të sakta rreth një gjendje të njohur më parë. Rekonstruimi dallohet nga restaurimi me futjen e materialit të ri. Materiali i ri mund të përfshijë materiale të ricikluara dhe të shpëtuara nga asetit.


Adaptimet dhe ndryshimi i funksionit janë te pranueshme, nëse:


1. Intervenimi i propozuar ka ndikim minimal në vlerat dhe rëndësinë e asetit;
2. Intervenimi ka qëllim të ruajë organizimin funksional dhe tipologjinë;
3. Çdo ndërhyrje bëhet me materiale dhe sisteme reversibile, dhe njëkohësisht çdo ndërhyrje e re është qartë e dallueshme si ndërhyrje e kohës.

Ndryshimet që dëmtojnë vlerat e trashëgimisë në një aset janë të papranueshme, përveç nëse:

1. Ndryshimet janë të domosdoshme për qëndrueshmërinë e asetit;
2. Nuk ekzistojnë praktika për ta bërë intervenimin pa shkaktuar dëm;

Rrjedhimisht, bazuar dhe në vendimin e Komisionit të Ankesave – materiali që duhet të përdoret për shtrimin e rrugës është kalldrëmi me dimensione ~10x10cm i kombinuar me kalldrëm shqiptar e bazuar në gjendjen e fundit të dokumentuar dhe me fotografi dhe të ilustruar grafikisht më poshtë si material autentik.





Vërejtje: Parimet e konservimit të përcaktuara më lart, nuk mund të plotësohen/ndryshohen.

Duke u mbështetur në Ligjin për Trashëgimi Kulturor Nr. 02/L-88, në zbatim të Rregullores Nr. 06/2017, Për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturorë, Vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Cilësinë e Institucionit Kompetent, Projekti Ideor dhe Projekti Kryesor për Konservim, duhet të aprovohet nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve (IKMM).

SHTOJCA 1: LISTA E DOKUMENTEVE QË DUHET TË PËRMBAJË LËNDA PËR SHQYRTIM NGA KOMISIONI PROFESIONAL / IKMM

QRTK ose INSTITUCIONI		
Nr.	Përshkrimi	Shënim (✓, X)
1.	Kërkesa nga pala (Veprimi që kërkohet: konservim, restaurim, rikonstruim, ndërtim i ri, ankesë, rrënim, ...)	
2.	Kërkesa nga Komuna përkatëse për QRTK/IKMM	
3.	Fleta përcjellëse për kërkesën/lëndën nga QRTK	
4.	Certifikata e pronësisë (jo më e vjetër se 6 muaj)	
5.	Kopja e Planit (jo më e vjetër se 6 muaj)	
6.	Gjendja burimore (nëse ekziston) Gjendja ekzistuese e ndërtesës (nëse ka ndërtesë) - Situacioni i gjerë P=1:500 ose P=1:1000 - Situacionin e ngushtë P=1:200 - Bazat (P=1:100) - 2 Prerje (P=1:100) - 4 Fasada (P=1:100) - Detajet - Përshkrimi teknik i intervenimeve (paramasa dhe parallogaria)	
7.	Incizimi gjeodezik (kompania ose gjeodeti i licencuar) (Vendosja e ndërtesës në bazë dhe prerje në terren - të saktësohet kuota 0.00)	

SHTOJCA 2: LISTA E DOKUMENTEVE QË DUHET TË PËRMBAJË LËNDA PËR SHQYRTIM NGA KOMISIONI PROFESIONAL /IKMM

QRTK ose INSTITUCION		
Nr.	Përshkrimi	Shënim (✓, X)
1.	Dosja e kompletuar e inventarizimit për asetin në fjalë (nëse mungon dosja complete e inventarizimit, atëherë është e domosdoshme që dosja ta ketë së paku deklaratën e rëndësisë nga QRTK përkatëse)	
2.	Projekti ideor i propozuar - Situacioni i gjerë P=1:500 ose P=1:1000; - Situacioni i ngushtë P=1:200; - Bazat, - 2 Prerje, - 4 Fasada P=1:100; - Perspektivat, - Detajet - Përshkrimi teknik	
3.	Dokumentacioni (historiku, karakteristikat e monumentit)	
4.	Foto dokumentacion (orto foto, fotografitë jo më të vjetra se 6 muaj)	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth & Sport

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	3565/2021
Data	04.10.2021
Signature	<i>Adonaj Lajç</i>
PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINA	

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në procedurën e vendimeve për leje dhe pëlqime
nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve

Nr. 02/2021

Datë: 04.10.2021

Komisioni për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, në procedurën e dhënies së lejeve dhe pëlqimeve në trashëgiminë kulturore arkitekturore, në mbështetje të nenit 14 (paragrafi 2), 125, 127, 128, 131 dhe 132 të Ligjit Nr.05/L – 031 për Procedurën Administrative, si dhe duke u bazuar në Vendimin Nr.38/2019 të datës 19.03.2019, me Nr. të Protokollit 1030/2019 të datës së Protokollit 21.03.2019 të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, në procedurën e dhënies së lejeve dhe pëlqimeve në trashëgiminë kulturore arkitekturore, duke vendosur mbi ankesën me Nr. 3159/2021, të datës 13.09.2021 të parashtruar nga pala, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara pretendimet mos pajtuese të parashtruara në shkresën me Nr. të Protokollit 3159/2021, të datës 13.09.2021, të parashtruar nga Sali Shoshi, arkitekt ashtu që lënda e konstatuar, kthehet për rishqyrtim dhe rivendosje në përputhje me të gjeturat e evidentuara në arsyetimin e këtij Vendimi.
2. Shfuqizohet Vendimi Nr.36/2021, i datës 02.09.2021, me Nr. protokoli 263, të datës 02.09.2021 i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
3. Obligohet Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga anëtarët e Komisionit për Shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, në procedurën e dhënies së lejeve dhe pëlqimeve në trashëgiminë kulturore arkitekturore.

A R S Y E T I M

Në përputhje me kërkesat e Komisionit të Ankesave në relacion me plotësimin e lëndës, me dokumentacionin përkatës si:

1. Gjendjen ekzistuese;
2. Prezantimin grafik të variantit të përzgjedhur (në vendim kombinimi i varianteve 2 dhe 5) si dhe dukjet;

3. Specifikacionin për materialet;

Komisioni i Ankesave më datë 01.10.2021 gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të sjellur, ka konstatuar se projekti është plotësuar me të tri kërkesat.

Sa i përket pikës së tretë, specifikimi i materialeve është dorëzuar vetëm në formë të paramasës dhe parallogarisë.

Nga përshkrimi i pozicioneve, te pjesa II Punët e Gërmimit, pika 1, përshkruhet qartë se do të bëhet gërmimi i shtresave të rrugës me gjithë beton, duke përfshirë këtu edhe largimin e kalldrëmit ekzistues – kubëzave të granitit. Te pjesa IV Punët e Granitit dhe Betonit, pika 1, pastaj pikat 3.1 e 3.2, përshkruhet se do të bëhet vendosja e pllakave të gurëve natyrorë- gurë lumi të përpunuar (me dimensione 20 deri 50 cm gjatësi dhe 40 cm gjerësi, me trashësi 8 cm), në tërë gjatësinë dhe në të dy anët e Çarshisë së Madhe.

Për arsyet si më lartë, Komisioni i Ankesave kërkon që projekti të kthehet në rishqyrtim, vetëm sa i përket materialit të përdorur për shtresën e sipërme të tërë gjatësisë së rrugës së Çarshisë së Madhe të Gjakovës.

Kjo, sepse Komisioni konsideron se materiali i propozuar, pllakat e granitit në fjalë, nuk përputhen as në pamje, as në dimensione, me materialin origjinal dhe autentik të gjendjes burimore të rrugës, e cila ka qenë e shtruar me kalldrëm.

Me këtë, Komisioni i Ankesave, ka konstatuar se shqyrtimi i lëndës në shkallën e parë nuk ka përfillur materialisht kërkesat dhe standardet profesionale të mishëruara në Ligjin për Trashëgimi Kulturor, aktet nënligjore dhe standardet teknike profesionale në fuqi.

Duhet pasë parasysh se flitet për bërthamën e Tërësisë Urbanistike të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, e cila është njëra nga asetet e rëndësishme më të lartë me të cilën identifikohet qyteti i Gjakovës.

Kërkohej po ashtu, që Komisioni i IKMM-së, ta përmbushë në një kohë sa më optimale kërkesën e Komisionit të shkallës së dytë, në mënyrë që t'i hapet rrugë punimeve të fazave të tjera në këtë aset.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë të drejtën e ngritjes së mjetit juridik të kontrollit gjyqësor të aktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi i dërgohet:

Kabinetit të Ministrat

Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm

Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Gjakovë

Inspektorati për Trashëgimi Kulturor

Komuna e Gjakovës

Arkivit të MKRS-së

Komisioni në përbërje të:

Vjollca Aliu – kryesuese;

Merita Augustini Nrecaj; - Anëtare;

Bislim Bislimi – Anëtar;